

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË, në kolegjin e të pestëve të përbërë nga gjyqtarët: Ismet Emra - kryetar, Sllobodan Zhivković, gjyqtarët porotë Ilaz Alija, Dojcin Maksimović dhe Osman Kosović - anëtarë kolegji, me procesmbajtësen Hanumsha Brahimi dhe interpretin Ragip Luma, në lëndën penale të akuzuarve: HALIL ALIDEMA, nga Prishtina, të cilin e mbrojnë Adem Vokshi - avokat nga Mitrovica e Titos, EKREM KRYEZIU, nga Prishtina, të cilin e mbrojnë Adem Bajri - avokat nga Peja, Hasan Kryeziu - avokat nga Prishtina, UKSHIN HOTI, nga Prishtina, të cilin e mbrojnë Bajram Kelmendi - avokat nga Prishtina, MENTOR KAÇI, nga Prishtina, të cilin e mbrojnë: Adem Bajri - avokat nga Peja, Millo拉德 V. Filipović - avokat nga Prishtina, HILMI RATKOCERI, nga fshati Llugagji - Komuna e Lipjanit, të cilin e mbrojnë Vukoje Joković - avokat nga Prishtina, ALI KRYEZIU, nga Peja, të cilin e mbrojnë Adem Bajri - avokat nga Peja, Gavrillo Vulleviq - avokat nga Peja, NEZIR HALITI, nga Ferizaj, të cilin e mbrojnë Mehmet Dushku - avokat nga Prishtina, SHEMSI REÇICA, nga fshati Gllavicë, Komuna e Lipjanit, të cilin e mbrojnë Franklin Sedaj, avokat nga Prishtina - për shkak të veprave penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114. i LP të RSFJ., dhe MUHARREM FETIU, nga Prishtina, të cilin e mbrojnë Hasan Kryeziu - avokat nga Prishtina, për shkak të veprave penale Moskallëzimi i përgatitjes së veprave penale nga neni 172. al.1. të Ligjit penal KSAK., sipas aktakuzës të Prokurorisë publike të qarkut në Prishtinë PP-nr.281/81 të datës 31. maj të vitit 1982., pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor verbal publik, më 19, 20, e 21. korrik të vitit 1982. në pra-

ninë e zëvendës Prokurori publik të qarkut në Prishtinë - Miftar Jasiqit, të akuzuarvet dhe mbrojtësvet të tyre, më 22. korrik të vitit 1982., jep dhe njëherit publikisht shpall këtë

A K T G J Y K I M

TË AKUZUARIT:

1. HALIL ALIDEMA, i biri i Behxhetit dhe Zades - e gjinisë Imeri, i lindur më 13.03.1936. në fshatin Pozharan - Komuna e Vitisë, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rr. "Ganimete Tërbeshi" nr.2., Shqipëtar, shtetas i RSFJ, i martuar - baba i 3.fëmive, ka kryer fakultetin e drejtësisë në Prishtinë dhe shkallën e tretë të studimeve, është magjistër i shkencave të historisë, i punësuar në Fakultetin filozofik në Prishtinë - referent i organeve vetëqeverisëse, shërbimin ushtarak e ka kryer në vitin 1963. në Novi Sad, evidentohet në EU pranë KK-Prishtinës, i gjendjes së mirë ekonomike, i padënuar, kundër tij nuk zhvillohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, në paraburgim prej 24.12.1981.,

2. EKREM KRYEZIU, i biri i Remziut dhe Hyzrenes - e gjinisë Kryeziu, i lindur më 01.06.1943. në Pejë, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rr."Avalles" nr.39., Shqipëtar, shtetas i RSFJ, i martuar - baba i 3. fëmive, ka kryer fakultetin e artit të drames - seksioni i dramaturgjisë në Beograd, regjisor i punësuar në RTV. të



Prishtines, i liruar nga shërbimi ushtarak për kohë të pagës, i evidentuar në EU pranë KK - Pejë, i gjendjes së mirë ekonomike, i padënuar, kundër tij nuk zhvillohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, në paraburgim prej 21.12.1981.,

3. UKSHIN HOTI, i biri i Nazifit dhe Fatimes- e gjinisë Thaqi, i lindur më 16.06.1943. në Fshatin Krusha e Madhe - Komuna e Rahovecit, me vendbanim të përherëshëm në Prishtinë Lagja "Ulpiana", objekti 29/V, hyrja e II. nr.7. Shqipëtar, shtetas i RSFJ, i martuar - baba injë fëmie, ka krya fakultetin e shkencave politike në Zagreb dhe studimet postdiplomike në Beograd - është magjistër i shkencave politike, ligjerues në fakultetin filozofik në Prishtinë, shërbimin ushtarak e ka krya në vitin 1970., në Beograd, i evidentuar në EU pranë KK - Prishtinë, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar, kundër tij nuk zhvillohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, në paraburgim prej 24.12.1981.

4. MENTOR KAÇI, i biri i Hamzes dhe Pakizes-e gjinisë Shala, i lindur më 07.06.1952. në Gjakovë, me vendbanim të përherëshëm në Prishtinë, lagja "Lakërishtë", lamella III. nr.56., Shqipëtar, shtetas i RSFJ, i martuar - baba i 2.fëmive, absolvent i fakultetit të drejtësisë në Prishtinë, montazher i punësuar në RTV - Prishtinë, shërbimin ushtarak e ka krya në vitin 1980. në Sarajevë, evidentohet në EU pranë KK - Gjakovë, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar, kundër tij nuk zhvillohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, në paraburgim prej 21.12.1981.,



5. HILMI RATKOCERI, i biri i Hajrushit dhe Shukurijes - e gjinisë Mustafa, i lindur më 15.08.1955. në fshatin Llugagji - Komuna e Lipjanit, ku edhe përherë banon, Shqipëtar, shtetas i RSFJ, i pamartuar, apsolvent i fakultetit filozofik në Prishtinë - sektori i gjuhes dhe letërsisë shqipe, arsimëtar në QAMO "Josip Broz Tito" në Ferizaj, shërbimin ushtarak e ka krya në vitin 1981. në Beograd, evidentohet në EU pranë KK - Lipjan, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar, kundër tij nuk zhvillohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, në paraburgim prej 21.12.1981.,

6. ALI KRYEZIU, i biri i Remziut dhe Hyrzemes-e gjinisë Kryeziu, i lindur më 09.08.1950. në Pejë, ku edhe përherë banon rr. "Vllada Raiçeviq" nr.34., Shqipëtar, shtetas i RSFJ, i martuar - pa fëmijë, ka krya fakultetin e drejtësisë në Prishtinë, i punësuar në Ndërmarrjen "Agro-Kosova" në Prishtinë, shërbimin ushtarak e ka krya në vitin 1977., në Shkup, i evidentuar në EU pranë KK - Pejë, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar, kundër tij nuk zhvillohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, në paraburgim prej 21.12.1981.,

7. NEZIR HALITI, i biri i Halitit dhe Nebijes - e gjinisë Palloshi, i lindur më 16.09.1948., në fshatin Firajë, Komuna e Ferizajit, me vendbanim të përherëshëm në Ferizaj rr. "Bihaqit" nr.9., Shqipëtar, shtetas i RSFJ, i martuar - baba i 4.fëmive, ka krya fakultetin filozofik në Prishtinë - sektori i gjuhes dhe letërsisë shqipe, profesor në Shkollën fillore "P.Tepavçeviq" në Ferizaj, shërbimin ushtarak e ka krya në vitin 1974., në Danilovgrad, i evidentuar në EU pranë KK-Ferizaj, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar, kundër tij nuk zhvillohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, në paraburgim prej 05.04.1982.



8. SHEMSI REÇICA, i biri i Ismailit dhe Emines-
e gjinisë Dragusha, i lindur më 02.09.1952. në fshatin
Gllavicë - Komuna e Lipjanit, ku edhe përherë banon, Shqi-
pëtar, shtetas i RSFJ, i martuar - baba i 2.fëmive, ka
krya fakultetin filozofik dhe shkallën e tretë të studime-
ve, profesor i fillozofisë marksiste dhe logjikes në Fakul-
tetin filozofik në Prishtinë, shërbimin ushtarak e ka kra
në vitin 1980. në Rajllovac, i evidentuar në EU pranë KK-
Lipjan, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar kundër
tij nuk zhvillohet procedura për ndonjë vepër tjetër pe-
nale, në paraburgim prej 21.12.1981., dhe

9. MUHARREM FETIU, i biri i Jusufit dhe Hamdi-
jes - e gjinisë Sahitaj, i lindur më 07.01.1945. në fsha-
tin Peqanë - Komuna e Suharekes, me vendbanim të përherë-
shëm në Prishtinë, lagja "Dardanija", blloku IX/IV nr.23,
Shqipëtar, shtetas i RSFJ, i martuar - baba i 3.fëmive, ka
krya fakultetin filologjik - grupi i albanologjisë, është
magjistër i shkencave të historisë, referent për mësim në
fakultetin filozofik në Prishtinë, nga shërbimi ushtarak
i liruar në kohë të pacaktuar, evidentohet në EU pranë KK-
Prishtinë, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar, ku-
ndër tij nuk zhvillohet procedura për ndonjë vepër tjetër
penale, në paraburgim prej 21.12.1981. gjer më 07.04.1982,
tani mbrohet nga liria,

j a n ë f a j t o r

SEPSE:

me qëllim të kryerjes të veprave penale të drejtuara në
rrëzimin e pushtetit të klases punëtore dhe të punonjësve,



thyerjen e vllazërimit e të bashkimit, prishjen e barazisë së kombeve e të kombësive dhe nryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të RSPJ,

I. I akuzuari HALIL ALIDEMA:

Që nga viti 1979., në takime dhe gjatë bisedave me të akuzuarit Hilmi Ratkocerin dhe Nezir Halitin si dhe me persona tjerë në Ferizaj, filloi të përhapë qëndrimet e tij armiqësore në drejtim të realizimit të statutit për Republikën e Kosovës dhe të bashkimit të popullit shqipëtar, e në këtë drejtim kërkoi përkrahje dhe angazhimin e tyre, e pastaj, pas demonstratave armiqësore e kundërrevolucionare të muajit mars dhe prill të vitit 1981., në shumë takime, kontakte, ndeja dhe gjatë bisedave me të akuzuarit Ekrem Kryeziun, Ukshin Hotin, Mentor Kaçin, Hilmi Ratkocerin, Nezir Halitin, Shëmsi Reçicen dhe Muharrem Fetin, në Prishtinë, Ferizaj dhe gjetiu, i përkrahu në tërësi demonstratat, kërkesat dhe parullat e këtyre demonstratave, nga i akuzuari Ekrem Kryeziu, muar dhe e lexoi materialin propagandistik nga revista "Liria nr.3." të organizatës ilegale "Marksiste-Leniniste të Kosovës" me titull "Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe patjetër do të triumfojë", e pastaj këtë e lexuan, e analizuan dhe e komentuan së bashku me të akuzuarit Ekrem Kryeziun e Ukshin Hotin, nga i akuzuari Ukshin Hoti kërkoi që ti shkruaj Organizatës së kombeve të bashkuara lidhur me kërkesat e demonstrantëve për statusin e "Republikes së Kosovës", në mënyrë që atje të nxitet përkrahja për këtë kërkesë, nga i akuzuari Hilmi Ratkoceri kërkoi që ti siguroj getshtetnerin për shumzimin e materialet propagandistik dhe që ai, si edhe i akuzuari Nezir Haliti, të angazhohen për masovizimin e qytetarve për daljen në demonstrata, shkruarjen, shpërndarjen e parullave dhe të pamfleteve në Ferizaj, u

furnizua me materialin propagandistik "Teoria dhe praktika e revolucionit" të Qendres për edukimin Marksist pranë Këshillit qendror të PKMLSHJ, të cilin pastaj ia dha për ta lexuar të akuzuarit Ali Kryeziut, nga i akuzuari Mentor Kaçi kërkoi që të mbledh shenime dhe ta informoi lidhur me numërin, vendosjen dhe lëvizjen e forcave APJ. dhe atyre të milicisë në territorin e Komunes së Gjakoves si dhe llojin e armatimit dhe të mjeteve transportuese të këtyre forcave, për numërin e studentëve, të cilët nuk kanë mundur të regjistrohen në fakultete dhe shkolla të larta të Univerzitetit të Kosovës, për shkak të pjesëmarrjes në demonstrata e me qëllim që për këtë ti shkruajnë OKB, kinëse për padrejtësitat që u bëhën këtyre studentëve, nga i akuzuari Ekrem Kryeziu, kërkoi dhe muarr njoftime lidhur me objektet transmetuese të RTV të Prishtinës me qender në Golesh dhe mundësinë e dëpërtimit fshehurazi në këtë transmetues si dhe për mundësinë e sigurimit të armëve në rast nevojë nga depotë e RTV të Prishtinës dhe atyre ushtarake për rreth këtij transmetuesi, me të akuzuarin Ali Kryeziun e shqyrtuan nevojen e ikjes - largimit nga treva e Kosovës të njërit prej personave më të aftë, i cili gëzon autoritet të lartë në popull me qëllim që, kështu të krijohet situatë e rëndë psiqike në opinjon në drejtim të destabilizimit dhe krijimit të situatës së rëndë politike në RSFJ, i cili kishte për të vepruar në mënyrë armiqësore nga jashtë, pastaj në muajin nëntor të vitit 1981. i dha për detyrë këtij të akuzuari që pas shkuarjes në SHBA të kërkojë ndihmë materiale për blerjen e armëve nga emigrantët e atjehit, ndërsa gjatë pushimeve verore në Stamboll të Turqisë është takua me konzulin e RPSSH në Stamboll, me të cilin bisedoi dhe komentoi situatën dhe gjendjen politike në Kosovë pas demonstratave,

- me këtë ka krya vepren penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114. të LPJ.,

II. I akuzuari EKREM KRYEZIU:

Pas demonstratave armiqësore e kontrarevolucionare të muajit mars dhe prill të vitit 1981., në shumë biseda, kontakte dhe ndeja me të akuzuarit Halil Alidemen e Ukshin Hotin, i përkrahu në tërsi demonstratat, kërkesat dhe parullat e demonstratave, pastaj në kërkesën e të akuzuarit Halil Alidemes, këtij ia vizatoi skicen e objekteve transmetuese të RTP me qender në Golesh, duke i shpjegua mundësinë e afrimit fshehurazi, pa u vrejtur nga i vetmi rojtar që e ruan këtë objekt dhe depërtimin në te, për mundësinë e pengimit të programit televiziv si dhe i ofroi të dhëna për mundësinë e sigurimit të armëve në rast nevojë nga depotë e RTP. për të cilat ka tre-gua se janë të mbyllura të konstrukcionit dhe materialit të dobët si dhe nga depotë ushtarake, të cilat nuk janë mirë të ruajtura, nga i akuzuari Mentor Kaçi muarr dhe e lexoi artikullin në formë të pamfletit nga revista "Liria" nr.3." të organizates ilegale "Marksiste-Leniniste të Kosovës" me titull "Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe pa tjetër do të triumfojë", e cila i është kushtua demonstratave në Kosovë, rezultateve dhe arsyeshmërisë të këtyre demonstratave, të cilin pastaj ia dha të akuzuarit Halil Alidemes, e më vonë që të tre këta të akuzuar e lexuan dhe e komentuan së bashku në shtëpinë e të akuzuarit Ukshin Hotit, ndërmjetësoi në mes të akuzuarit Halil Alidemes dhe Ukshin Hotit lidhur me shkruarjen e apelit OKB. nga i akuzuari Ukshin Hoti, si dhe së bashku me të akuzuarin Ukshin Hotin në fshatin Krusha e Madhe, dëgjuan inqizime në shiritin magnetofonik të artikullit të gazetes RPSSH. "Zëri i popullit", që është emitua në valet e radios dhe TV. të Tiranës, në të cilin janë përkrahë demonstratat, kërkesat dhe parullat e këtyre demonstratave në Kosovë, ndërsa nga i akuzuari Ali Kryeziu u njoftua se me rastin e shkuarjes të këtij në SHBA. do të angazhohet në mbledhjen e ndihmes



në të holla nga emigrantët e atjehit për të blerë armë,

- me këtë ka krya vepren penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114.LPJ,

III. I akuzuari UKSHIN HOTI:


Pas demonstratave armiqësore dhe kontrarevolucionare të muajit mars dhe prill të vitit 1981., në shum biseda, kontakte dhe ndeja me të akuzuarit Halil Alidemen dhe Ekrem Kryeziun, në Prishtinë e gjetiu, i përkrahu në tërësi demonstratat, kërkesat dhe parullat e këtyre demonstratave e në biseda me këta është deklarua se për fitimin e Republikës së Kosovës, duhet vazhdua aktivitetin e shkruarjes së parullave, shpërndarjes të pamfleteve dhe të shkaktimit të aksidenteve me organet e sigurimit publik si dhe udhëheqësit politiko-shoqëror gjatë mbledhjeve të ndryshme nëpër organizatat punuese dhe të OTH të LK., e në këtë drejtim duhet mobilizua masën e gjërë, pastaj marr përsipër që lidhur me kërkesën për statusin e Republikës së Kosovës ti shkruaj një apel OKB. në mënyrë që atje të nxitet përkrahja për këtë kërkesë, me të akuzuarit Halil Alidemen dhe Ekrem Kryeziun e lexuan dhe e komentuan artikullin në formë të pamfletit nga revista "Liria nr.3." të organizatës ilegale "Marksiste-leniniste të Kosovës" me titull "Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe patjetër do të triumfojë", e cila i është kushtua zhvillimit të demonstratave, arsyeshmërisë të demonstratave dhe të kërkesave të demonstratave në Kosovë, pastaj së bashku me të akuzuarin Ekrem Kryeziun në shtëpinë e dëshmitarit Xhemajl Dana në Krushen e Madhe dëgjuan inqizime në shiritin magnetofonik të artikullit të gazetes RPSSH "Zëri i popullit që është emitua në valet e radios dhe TV të Tiranës, ndërsa në shtëpinë e vet dy here inqizoi në shiritin magnetofonik artikuj tjerë të gazetes "Zëri i popullit" që janë emitua në valet e radio dhe TV të Tiranës,

me të cilët artikuj përkrahen demonstratat e marsit dhe prillit të vitit 1981. në Kosovë dhe sulmohet sistemi i RSFJ, si dhe të akuzuarit Ekrem Kryeziut i propozoi që pas shkuarjes legale në Greqi të kërkojnë azil politik në Ambasadën e SHBA, ku pastaj të shkojnë në SHBA, prej nga do të vazhdonin veprimtarinë armiqësore kundër RSFJ në drejtim të fitimit të statusit të Republikës së Kosovës,

- me këtë ka krya vepren penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114.LPJ.

IV. I akuzuari MENTOR KAÇI:

Pas demonstratave armiqësore dhe kontrarevolucionare të muajit mars dhe prill të vitit 1981., në shumë biseda, kontakte dhe ndeja me të akuzuarin Halil Alidemen, i përkrahu në tërsi demonstratat, kërkesat dhe parullat e demonstratave, pastaj sipas kërkesës të akuzuarit Halil Alidemes, muarr përsipër, mbledhi dhe këtij i dha informata lidhur me numërin, vendosjen dhe lëvizjen e forcave të APJ. dhe të atyre të milicisë, llojin e armatimit dhe të mjeteve transportuese në territorin e Komunës së Gjakovës si dhe muarr përsipër mbledhjen e shenimeve për numërin e studentëve, të cilët nuk kanë gëzua të drejtën e regjistrimit nëpër fakultete dhe shkolla të larta të Universitetit të Kosovës për shkak të pjesëmarrjes në demonstrata, në mënyrë që i akuzuari Halil Alidema pastaj ti shkruaj për këtë OKB, duke thekësua, kinëse padrejtësitë që u bëhën këtyre studentëve, u furnizua me materialin propagandistik në formë të pamfletit nga revista "Liria nr.3." të organizatës ilegale "Marksiste-Leniniste të Kosovës" me titull "Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe patjetër do të triumfojë", në të cilin përkrahen demonstratat, kërkesat e këtyre demonstratave



dhe trajtohet arsyeshmëria e këtyre demonstratave, të cilin e lexoi e pastaj ia dha të akuzuarit Ekrem Kryeziut, i cili pasi e lexon ja dha të akuzuarit Halil Alidemes, e këta të dy e lexuan së bashku edhe me të akuzuarin Ukshin Hotin, duke e komentua dhe analizua në shtëpinë e të akuzuarit Ukshin Hotit,

- me këtë ka krya vepren penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114.LPJ.,

V. I akuzuari HILMI RATKOCERI:

Që nga viti 1979., në Ferizaj dhe Prishtinë, pas takimit me të akuzuarin Halil Alidemen, pranoi idetë e tij që të angazhohet në veprimtarinë armiqësore në drejtim të realizimit të kërkesës për statusin e Republikës së Kosovës dhe të bashkimit të popullit shqipëtar, e në këtë drejtim të akuzuarin Halil Alidemen, sipas kërkesës së tij, e njoftoj rreth shkruarjes së parullave me përmbajtje armiqësore në shkollen e mesme ekonomike në Ferizaj në vitin 1979., përmbajtjen e këtyre parullave si dhe thyerjes të fotografisë së Shokut TITO dhe kush prej nxënësve i ka krya këto aksione dhe masat që janë ndërmarrë ndaj tyre, mandej pas demonstratave armiqësore dhe kontrarevolucionare të muajit mars dhe prill të vitit 1981., në shumë biseda dhe kontakte me të akuzuarin Halil Alidemen, i përkrahu demonstratat, kërkesat dhe parullat e demonstratave e në drejtim të realizimit të këtyre kërkesave dhe parullave të akuzuarit Halil Alidemes i premtoi sigurimin e getështetnerit për shumëzimin e materialit propagandues, pastaj pranoi që ta informoj për diskutimet në mbledhjet e OTH të LK. në shkollen ku jep-te mësim, si i gjykojnë demonstratat dhe çfarë masa po ndërmirren kundër demonstrantëve, kurse vet muarr përsipër të veproj në masovizimin edhe me personat tjerë




për të veprua në këtë drejtim e kështu kontaktoi dhe angazhoi edhe personat tjerë për të cilën gjë pastaj e njofton të akuzuarin Halil Alidemen, i cili e caktoi datën për të shkua dhe kontaktua në Ferizaj me këta persona dhe për ti furnizua me material propagandues me përmbajtje armiqësore si dhe për ti udhëzua për vazhdimin e punës me shkruarjen dhe shpërndarjen e parullave dhe të pamfleteve me karakter armiqësor, në mënyrë që të elektrizojë dhe frymëzojë masën në drejtim të kërkeses që Kosova të fitojë statusin e Republikës,

- me këtë ka krya veprën penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114.LPJ.,

VI. I akuzuari ALI KRYEZIU:

Pas demonstratave armiqësore e kontrarevolucionare të muajit mars dhe prill të vitit 1981., në shumë biseda dhe ndeja në Prishtinë me të akuzuarin Halil Alidemen, i përkrahu në tërësi demonstratat, kërkesat dhe parullat e demonstratave dhe u deklarua se duhet vazhdua edhe më tutje me shkruarjen e parullave dhe shpërndarjen e pamfleteve, nga i akuzuari Halil Alidema e muarr dhe e lexoi pamfletin e Qendres për edukimin Marksist pranë KQ të PKMLSHJ, me titull "Teoria dhe praktika e revolucionit" për përmbajtjen e të cilit është shprehur në superlativ dhe se duhet vazhdua aktivitetin në drejtim të realizimit të qëllimeve të parashtruara në këtë pamflet, duke angazhua të gjitha strukturat e kombësisë shqipëtare, së bashku e parashtrojnë nevojën e emigrimit në RSP të Shqipërisë të personit më të aftë, i cili gëzon autoritet në popullin e Kosovës dhe i cili prej atjehit kishte për ti përkrahur kërkesat e parashtruara në demonstrata për statusin e Republikës së Kosovës, si dhe me rastin kur desht të shkojë, në muajin nëntor të



vitit 1981. në SHBA, muarr përsipër angazhimin që nga emigrantët e atjehit të mbledhë ndihma në të holla për blerjen e armëve, e për këtë e njoftoi edhe të akuzuarin Ekrem Kryeziun,

- me këtë ka krya vepren penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114.LPJ.,

VII. I akuzuari NEZIR HALITI:

Pas demonstratave armiqësore dhe kontrarevolucionare të muajit mars të vitit 1981., në takim dhe bisedë me të akuzuarin Halil Alidemen, i përkrahu në tërësi kërkesat dhe parullat e demonstratave dhe muarr përsipër që të angazhohet në drejtim të masovizimit të nxënësve të shkolles fillore ku punon dhe disa punëtor tjerë të arsimit, që të organizojnë dhe dalin në demonstratë në Ferizaj, të brohorisin e të parashtrojnë kërkesë, me të cilat kërkohet që Kosova të fitoi statusin e Republikës, e pas mbajtjes së demonstratave në Ferizaj të akuzuarit Halil Alidemes në Prishtinë i raportoi mbi zhvillimin e demonstratave, pjesëmarrjen e rinisë në to, organizimin e mirë, suksesin e tyre, e mandej pas bisedës me të akuzuarin Halil u pajtua për vazhdimin e mëtejme të kërkesës që Kosova të fitoi statusin e Republikës me shkruarjen e parullave dhe shpërndarjen e afisheve për ta elektrizua dhe nxitur masën e gjërë si dhe të përcillet disponimi i tyre,

- me këtë ka krya vepren penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114.LPJ.

VIII. I akuzuari SHEMSI REÇICA:

Pas demonstratave armiqësore e kontrarevoluci-




onare të muajit mars dhe prill të vitit 1981., në shumë biseda, kontakte dhe ndeja me të akuzuarin Halil Alide-men në Prishtinë, i përkrahu demonstratat, kërkesat dhe parullat e parashtruara në këto demonstrata për statusin e Republikës së Kosovës, duke theksuar se duhet vazhdua me shkrimin e parullave, shpërndarjen e afisheve si dhe për përpjekjen që ato të jenë sa më masovike dhe kështu të mbahet situata e acaruar gjër në pranverën e vitit 1982., kur duhet shkua në akcione konkrete, nëse gjër atëhere nuk fitohet statusi i Republikës së Kosovës, duke thekësua se për të gjitha këto vet është i gatëshëm sikur edhe populli i mbarë, ndërsa më 15. tetor të vitit 1981. në shtëpinë e Xhevat Reçices në fsh. Glavicë, mysafirve të pranishëm u ka folë që edhe mëtej duhet të vazhdohet me kërkesat që Kosova të bëhet Republikë dhe se deri te realizimi i qëllimit të kësaj kërke-se do të vihet me hater, apo me dhunë dhe me luftën e popullit për të drejtat e veta, ndërsa në shtëpinë e vet në fshatin Gllavicë dy herash në shirita magnetofonik ka inqizua dy artikuj të "Zërit të popullit", që janë emitua përmes TV të Tiranës, në të cilët përkrahen demonstratat dhe kërkesat e demonstratave si dhe sulmo-het sistemi i RSFJ. dhe i udhëheqësisë së saj, kurse gjatë pushimeve verore të vitit 1981. në Varnë të Bull-garisë kontaktoi me përfaqësuesit diplomatik të RPSSH me të cilët bisedoi dhe e analizoi situatën dhe gjendjen politike në Kosovë pas demonstratave,

- me këtë ka krya vepren penale Cenimi kontra-revolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114.LPJ., dhe

IX. I akuzuari MUHARREM FETIU:

Pas demonstratave armiqësore dhe kontrarevolu-cionare të muajit mars dhe prill të vitit 1981. në Kosovë



gjat bisedave të përditëshme dhe kontakteve me të akuzuarin Halil Alidemen, eksponimeve, propozimeve konkrete në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve armiqësore që ia ka bërë i akuzuari Halil Alidema në Prishtinë, si dhe me rastin kur i ka përkrahë demonstratat, parullat dhe kërkesat e demonstratave, shprehjen për nevojën e organizimit dhe vazhdimin të veprimtarisë armiqësore, ka dijtë se po pregaditet kryerja e vepres penale për të cilën sipas ligjit mund të jepet dënimi me burgim prej 5.vjetëve dhe më i rëndë, nuk e ka kallzuar në kohën kur ende ka qenë e mundur që të pengohet kryerja e saj, kurse vepra penale e Cenimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114.LPJ., është krya nga i akuzuari Halil Alidema,

- me këtë ka krya vepren penale Mosëkallëzimi i përgaditjes së vepres penale nga neni 172.al.1. të LPK.,

prandaj Gjykata për këto vepra penale, në bazë të nenit 114.LP të RSFJ, nenit 172.al.1.LP KSAK. dhe nenit 351. të Ligjit mbi procedurën penale, të akuzuarit i

G J Y K O N

HALIL ALIDEMEN, me dënim burgimi në kohë prej 11. (njëmbëdhjetë) vjet, në të cilin i llogaritet paraburgimi prej 24.12.1981. e mëtutje,

EKREM KRYEZIUN, me dënim burgimi në kohë prej 8. (tetë) vjet, në të cilin i llogaritet paraburgimi prej 21.12.1981. e mëtutje,



UKSHIN HOTIN, me dënim burgimi në kohë prej 9. (nëntë) vjet, në të cilin i llogaritet paraburgimi prej 24.12.1981. e mëtutje,

MENTOR KAÇIN, me dënim burgimi në kohë prej 7. (shtatë) vjet, në të cilin i llogaritet paraburgimi prej 21.12.1981., e mëtutje,

HILMI RATKOCERIN, me dënim burgimi në kohë prej 3. (tre) vjet, në të cilin i llogaritet paraburgimi prej 21.12.1981., e mëtutje,

ALI KRYEZIUN, me dënim burgimi në kohë prej 5. (pesë) vjet, në të cilin i llogaritet paraburgimi prej 21.12.1981., e mëtutje,

NEZIR HALITIN, me dënim burgimi në kohë prej 2. (dy) vjet, në të cilin i llogaritet paraburgimi prej 05. 04.1982., e mëtutje,

SHEMSI REÇICEN, me dënim burgimi në kohë prej 7. (shtatë) vjet, në të cilin i llogaritet paraburgimi prej 21.12.1981., dhe

MUHARREM FETIUN, me dënim burgimi në kohë prej 6. (gjashtë) muaj, në të cilin i llogaritet paraburgimi prej 21.12.1981. e gjer më 07.04.1982.

Në bazë të nenit 98.al.3. të Ligjit mbi procedurën penale (LPP) të akuzuarit obligohen që në mënyrë solidare të kompenzojnë shpenzimet e shkaktuara të procedurës penale dhe secili veq e veq të paguaj nga 1.000,00 din. në emër të paushalit.



A r s y e t i m i

Prokuroria publike e qarkut në Prishtinë me aktakuzen PP-nr.281/81 të datës 31.maj të vitit 1981., akuzoi Halil Alidemen, Ekrem Kryeziun, Ukshin Hotin, Mentor Kacin, Hilmi Ratkocerin, Ali Kryeziun, Nezir Halitin, e Shemsi Recicen, për vepra penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114.LPJ., kurse Muharrem Fetiun për vepër penale Mosëkallëzimi i përgaditjes së vepres penale nga neni 172.al.1.të LPK.. Pranë aktakuzes së paraqitur ka mbetur deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor edhe përfaqësuesi i akuzes - zëvendës i Prokurorit publik i qarkut - Miftar Jasiqi dhe ka propozua që të akuzuarit të shpallen fajtor për veprat e cekura penale dhe të ndëshkohen sipas ligjit.

I akuzuari Halil Alidema, në mbrojtjen e tij dhënë në shqyrtimin kryesor, pothuajse në tërësi mohon aktakuzen, sepse deklaratat e dhëna pranë organevet të shërbimit të sigurimit shtetëror i ka dhënë me dhunë dhe me to nuk pajtohet. Me deklaratat e dhëna në hetuesi gjithashtu nuk pajtohet edhe pse i ka nënshkrua personalisht, duke thënë se nuk ishte i vetëdijshëm nga pasojat e shkaktuara në procedurën e mëparme. Pranon faktin se të akuzuarit tjerë i njef dhe se meta ka zhvillua biseda, mirëpo bisedat i konsideron si shkëmbim mendimesh e jo akte armiqësore. Lidhur me materialin propagandistik me titull "Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe patjetër do të triumfojë", pranon se të njejtin e ka marrë nga i akuzuari Ekrem Kryeziu, ndërsa materialin tjetër propagandistik me titull "Teoria dhe praktika e revolucionit" deklaroi se e ka gjetur në oborrin e tij, mirëpo në tërësi mohon faktin se këto materiale i kanë analizua, lexua dhe komentua me të akuzuarit tjerë, Ekrem Kryeziun, Ukshin Hotin dhe Ali Kryeziun. Bisedën në

Stamboll me konzullin e RSSH. e spjeron si bisedë të zhvilluar nga kureshtja. Për deklaratat e dhëna në hetuesi, thot se të njejtat janë përshkrim i deklaratave të dhëna në procedurën paraprake pranë organeve të SHSSH. se nuk ka qenë i vetëdijshëm kur i ka nënshkrua, e pastaj shton se nuk ka qenë në gjendje ta ndiej gjyqtarin hetues, duke lënë mundësinë që në proces janë shkrua edhe fjalët të cilat nuk i ka deklarua. Lejonë ekzistimin emundësisë që deklaratat e tij në detale përputhen me deklaratat e të akuzuarve tjerë, por megjithatë mohon përgjegjësinë penale, sepse deklaratat i ka dhënë nën dhunë, peresion, duke i shkaktua lëndime trupore dhe për këtë është shërua në spital, në Shkup. Në fjalën përfundimtare, aprovon mbrojtjen e avokatit, kursesi nuk pajtohet se ka krya veprën penale, është i mendimit se akuzohet për botëkuptime politike, sepse biseda ka zhvillua me të akuzuarit tjerë, por jo biseda armiqësore.

Mbrojtësi i të akuzuarit Halil Alidemes - avokati Adem Vokshi, në fjalën përfundimtare, deklaron se akuza publike do të ishte me vend, sikurse përbazë të mërrren deklaratat e të akuzuarve dhënë në shqyrtimin kryesor të cilat ishin identike sa i përket të vërtetës, konsideron se në veprimet e të akuzuarit Halil Alidemes nuk ekziston vepra penale me të cilën ngarkohet, sepse komentimet e demonstratave nuk janë bërë me paramendim dhe me qëllime armiqësore, por ato paraqesin vetëm shkëmbim mendimesh me shokët. Deklaratat në hetuesi janë dhënë nën presion dhe nuk paraqesin bazë për marrjen e ndonjë vendimi ndëshkues. Të akuzuarit nuk i është dhënë mundësia e mbrojtjes në hetuesi, propozon që i akuzuari të lirohet nga akuza,. Poqëse i akuzuari Halil ka bërë veprim inkriminues, atëhere mund të bëhet fjalë për ekzistimin e kundërvajtjes.

I akuzuari Ekrem Kryeziu, në mbrojtjen e tij mohon thënjët nga akuza dhe faktin se ka përkrahë demonstratat



por ka qenë i mendimit se demonstratat janë inicua nga forcat e errta të Rankoviçit, apo të tjerëve, me qëllim që të ndalohet hovi i zhvillimit të popullit shqipëtar në Jugosllavi. Sa i përket parulles "Kosova Republikë", mendon se kjo është dhe duhet të jetë inicijativë e forcave progresive në krye me LKJ., nëqoftëse duhet të kërkohet një gjë e tillë, e deri në këtë konstatim ka ardhur bashkë me të akuzuarit Ukshin Hotin e Halil Alidemen, pasi që kanë lexua pamfletin me titull "Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe patjetër do të triumfojë". Mohon në tërsi deklaratat dhënë pranë organeve të SHSSH. dhe në hetuesi, sepse siq thotë ato i ka dhënë nën presionin e hatashëm psikik e fizik. Në fjalën përfundimtare plotësisht pajtohet me mbrojtjen e avokatëve, duke shtua se me asnjë provë në shqyrtimin kryesor nuk u argumentuan thënjët nga akuza. Propozon që provat e nxjera të vlerëson drejtë dhe të merret vendim në ligj i bazuar.


Mbrojtësit e të akuzuarit Ekrem Kryeziu, avokatët Adem Bajri e Hasan Kryeziu, konsiderojnë se thënjët nga akuza nuk janë argumentua dhe aktgjykimi nuk mund të mbështetet në deklaratat dhënë në hetuesi e më parë, sepse të akuzuarit nuk i është mundësua kontakti me mbrojtësin. Vetëm leximi i pamfletit, nuk mund të paraqes veprim të caktuar inkriminues, prandaj propozojnë që i akuzuari Ekrem të lirohet nga akuza.

I akuzuari Ukshin Hoti, në tërsi mohon thënjët nga akuza si të pavërteta, nuk i ka përkrahë demonstratat, por gjithëmonë ka qenë i mendimit se LKJ. si bartës duhet ta shqyrtoi dhe hapë bisedën për statusin e republikës të Kosovës. Inqizimet magnetofonike të artikujve nga "Zëri i popullit", i ka dëgjua dhe i ka bërë, mirëpo për nevojat e tij shkencore e jo për propagandë. Deklaratat në hetuesi dhe në procedurën e mëparme i ka dhënë nën presione të hatashme. Në fjalën përfundimtare akcepton mbrojtjen e avoka-

tit, duke shtua se ka qenë i bindur që nuk mund të gjyko-
hen bindjet dhe se inqizimi poligrafik ka tregua pafajsi-
në e tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit Ukshin Hotit, avokati
Bajram Kelmendi, konsideron që akuza publike, e cila ekskluzivisht mbështetet në deklaratat e të akuzuarve dhënë në hetuesi, është në kundërshtim të plotë me provat e nxjera në shqyrtim kryesor dhe se aktgjykimi nuk mund të mbështetet në provat nga hetuesia, sepse përpos tjerash të akuzuarit në procedurën paraprake dhe në hetuesi nuk patën mbrojtës, jo pse nuk deshtën mbrojtje, por nga shkaku se iu ndalua mbrojtja - angazhimi i avokatit, prandaj edhe është bërë shkelje esenciale e LPP., kur dihet se fjala është për veprat penale në të cilat mbrojtja është e obligueshme. Deklarata e të akuzuarit Ukshin fare nuk ndryshon që nga fillimi i procedurës. Për të akuzuarin Ukshin kërkon vetëm aktgjykim lirues, sepse nuk mund të syponon që në praninë e fakteve të vërtetuara mund të merret aktgjykim i llojit tjetër.

I akuzuari Mentor Kaçi në tërsi mohon thënjet nga akuza, se nuk i ka përkrahë demonstratat, materialin propagandistik nga revista "Lirija nr.3." e ka gjetur rastësisht dhe e ka lexua pa kurrfarë qëllimi dhe të njejtin ia ka dhënë Ekrem Kryeziut pa kërkesën e tij. Deklaratat në procedurën paraprake dhe në hetuesi i ka dhënë nën përdorimin e dhunës fizike dhe për të më lehtë ka qenë të pranoi se ka bërë veprimtari armiqësore, se sa ti ekspozohet rishtash tortuarave. Pastaj shton që tekstin e deklaratave e kanë përpiluar inspektorët, ka kërkuar mbrojtës qysh ditën e parë, edhe më vonë të gjyqtarët hetues, por kërkesa e tij nuk është aprovuar. Duke u pajtuar plotësisht me mbrojtjen e mbrojtësve të tij, propozon që Gjykata të marrë parasysh deklaratën dhënë në shqyrtimin kryesor, në kushtet normale dhe të përjashton ekzistimin e vepres penale me të cilën ngarkohet.




Mbrojtësit e të akuzuarit Mentor Kaqit, avokatët Adem Bajri e Millorad Fillipoviq, konsiderojnë se është bërë shkelje e dispozitave të procedurës penale, sepse të akuzuarit nuk i është mundësua angazhimi i mbrojtësit dhe paraqesin pyetjen se kujt i ka shërby kjo mënyrë e zhvillimit të procedurës. Në rastin konkret, sipas mendimit të tyre nuk është vërtetua dashja e të akuzuarit në kryerjen e veprës penale sipas akuzës, propozojnë që i akuzuari në mungesë të provave të lirohet nga akuza.

I akuzuari Hilmi Ratkoceri, në tërsi mohon thënë një nga akuza, sepse sipas mendimit të tij ato janë të pavërteta dhe paraqesin vetëm fjalët e inspektorve. Gjithashtu mohon faktin se ka përkrahë demonstratat. Deklaratat i ka dhënë pa mbrojtës, sepse nuk i është mundësua kontakti me avokatin dhe këto deklarata i ka nënshkrua nën presion fizik, në momentin kur nuk ishte i vetëdijshëm. Mbetet pranë deklaratës dhënë në shqyrtimin kryesor dhe është i mendimit se nga provat e nxjerra nuk mund të vërtetohet se është fajtor për vepër penale me të cilën akuzohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit Hilmi Ratkoceri - avokat i Vukoje Joković, është i mendimit që aktgjykimi nuk mund të bazohet në faktet e vërtetuara në procedurë jashtë ligjit, edhe sikur të merret i vërtetë pohimi i të akuzuarit në hetuesi, është e domosdoshme që i njëjti të vërtetohet së paku edhe me një argument. Konsideron se vetë bisedat nuk mund të paraqesin përgjegjësi penale dhe se në veprimtarinë e të akuzuarit Hilmi, nuk ekziston asnjë element kualifikues i vepres penale nga neni 114.LPJ., prandaj propozon lirimin e tij.

I akuzuari Ali Kryeziu, në mbrojtjen e tij deklaroi se nuk i ka përkrahur demonstratat se nga inspektorët




i është imponua të pranoi marrjen e pamfletit nga i akuzuari Halil Alidema, edhe pse atë material fare nuk e ka pasë në dorë. Kontakti me mbrojtësin i është lejua pasi është krya procedura e hetuesisë. Pajtohet me mbrojtjen e avokatëve, duke cekur se është për principet e bashkëjeteses, por pasi nuk qëndrojnë elementet e veprimtarisë armiqësore nga akuza, propozon që mbrojtja e tij të vlerësohet drejtë nga ana e Gjykatës dhe të lirohet nga akuza.

Mbrojtësit e të akuzuarit Ali Kryeziu, avokatët Adem Bajri e Gavrillo Vulleviq, janë të mendimit se nuk është e logjikëshme që bisedat verbale, private e familjare të paraqesin vepër penale. Përndryshe, as deklarata e të akuzuarit Ali nga hetuesia, e cila është dhënë pa prezencën e mbrojtësit të tij, nuk mund të shërbej si provë. Propozojnë lirimin e të akuzuarit nga akuza.

I akuzuari Nezir Haliti, në mbrojtjen e tij deklaron se akuza nuk është ngritur në bazë të argumenteve, por në bazë të sypozimeve e trillimeve, prandaj e njejta nuk është e vërtetë. Pajtohet me deklaratën dhënë në hetuesi dhe me mbrojtjen e avokatit, duke propozua që të lirohet nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit Nezir Halitit, avokati Mehmet Dushku, cekë faktin që i akuzuari Nezir, që prej fillimit të procedurës ka mohua kryerjen e vepres penale, sepse këtë as që e ka bërë, se në hetuesi janë cenua të drejtat e mbrojtjes të akuzuarvet, prandaj aktgjykimi nuk mund të bazohet në deklaratat e të akuzuarve nga hetuesia, konsideron që në situatën më të pavolitëshme për të akuzuarin mund të merret se ekzistojnë elementet e vepres penale nga neni 172.al.1.LPK.. Në mungesë të veprimtarisë inkriminuese, propozon që i akuzuari Nezir Haliti, të lirohet nga akuza.




I akuzuari Shemsi Reçica, në mbrojtjen e tij në tërësi mohon aktakuzën, duke thekësua se disa gjëra në akuzë janë interpretua ndryshe, se deklaratat e dhëna në procedurën paraprake dhe në hetuesi i kanë shkruar për shkak të presionit fizik e psikik, se kanë kërkuar mbrojtës, por kontakti me mbrojtës nuk i është lejua gjër sa është krya hetuesia. Pajtohet me mbrojtjen e avokatit, deklaron se nuk është marrë me veprimtari armiqësore, se inqizimin e artikujve e ka bërë nga kurreshtja, konsideron se gjatë shqyrtimit kryesor plotësisht është ndriqua e vërteta dhe beson që Gjykata në bazë të këtyre fakteve do të marrë vendim të drejtë.

Mbrojtësi i të akuzuarit Shemsi Reçices - avokati Franklin Sedaj, konsideron se në bazë të procedurës së mbajtur, nuk është vërtetua veprimtaria inkriminuese e të akuzuarit, ndërkaq mvarret se Gjykata do të jepë rëndësi procedures hetimore, apo fakteve të vërtetuara në shqyrtimin kryesor. Pasi mbrojtësit nuk i është lejua kontakti me të akuzuarit gjatë hetuesisë, nuk është e njoftur se hetuesia është zhvilluar në mënyrë të drejtë. Konsideron se me provat e nxjerra në veprimet e të akuzuarit nuk ekzistojnë tiparet e asnjë veprë penale, prandaj propozon lirin e pakusht të akuzuarit.

I akuzuari Muharrem Feti, mohon thënjet nga akuza, sepse nuk ka dijtë që veprimtaria e Halil Alidemes, ashtu siq ka qenë i njoftuar, ka mund të paraqes elemente të ndonjë veprimtarie armiqësore dhe pasi u pajtua plotësisht me mbrojtjen e avokatit, i propozon gjykatës që ta lirojë si të pafajshëm.

Mbrojtësi i të akuzuarit Muharrem Fetiut - avokati Hasan Kryeziu, është i mendimit se i akuzuari Muharrem është plotësisht i pafajshëm, sepse asi muhabetesh janë bë-



rë anë e mbanvëndit dhe se nuk ka qenë e mundur që i akuzuari Muharrem të dijë, se i akuzuari Halil Alidema përgaditet për kryerjen e vepres penale, për të cilën sipas ligjit mund të shqipëtohet dënim me burg prej 5.vjetë, ose më i rëndë dhenë mungesë të veprimeve inkriminuese, propozon që i akuzuari plotësisht të lirohet nga akuza.

Me provat e nxjera në shqyrtimin kryesor u vërtetua gjendja faktike si vijon:

I akuzuari Halil Alidema, para ca vitesh ka filluar të bisedojë me të akuzuarin Ekrem Kryeziun lidhur me veprimtari armiqësore, siq janë shfrytëzimi i Kosoves nga rrepublikat tjera, investimet e vogla që i bëhën Kosoves, duke u pajtua që Kosoves duhet dhënë Statusin e republikes. Pas demonstratave, bisedat e tyre kanë qenë më të hapta, i kanë dhënë përkrahje demonstratave, duke thekësuar se kjo është dëshira e popullit shqipëtar dhe demonstratat paraqesin një formë të luftes për fitimin e statusit të republikes, e poqë se në këtë mënyrë nuk arritet qëllimi, atëherë duhet shkua deri në fund dhe të "drejtat" të realizohen me aksione konkrete.

Pas demonstratave, i akuzuari Halil, zhvillon biseda me të akuzuarin Ekrem për mundësitë e mëtejshme, mënyrën e aktivizimit dhe kontribuimit të luftes për fitimin e statusit të republikes. I akuzuari Ekrem ka paraqitë mundësinë që mund të bëjë pengesa në emitimin e programit të TV - Prishtines, në relejin e Goleshit, duke spjegua se si është i ruajtur dhe se si është e mundur ti afrohen këtij objekti me çrast ka vizatua skicen e lokacionit dhe të lokaleve. Për të realizua aksionet e tyre armiqësore, kanë bërë biseda edhe për mënyrën e sigurimit të armëve, kështu i akuzuari Ekrem paraqet mundësin e sigurimit të armëve nga depotë e televizionit të Pri-

shtines, tueqenëse dyert e depove janë të konstrukcionit dhe materialit të dobët, por edhe mundësinë që armët mund të vidhen nga kazermat ushtarake, sepse të njejtat nuk janë mirë të ruajtura, e lidhur me këtë ka parasysh formimin e grupit prej 10. anëtarësh dhe se gjer tani ka bërë zgjidhjen e disa personave, të cilët punojnë në televizion, e që mund të angazhohen në aksionet armiqësore.

Pas diskutimit rreth demonstratave me të akuzuarin Halil Alidemen, i akuzuari Ukshin Hoti, është deklarua se duhet vazhduar me aktivitetin e shkrimit të parullave, shpërndarjen e pamfleteve, shkaktimin e aksidenteve, duke i përkrahë në tërësi demonstratat armiqësore.

I akuzuari Nezir Haliti, me rastin e takimit me të akuzuarin Halil Alidemen, pas demonstratave armiqësore të datës 26.03.1981., në tërësi i përkrahë demonstratat, duke thënë se është mirë që kandodhë kjo dhe që është kërkuar statusi i republikes për Kosovën, duke propozua që demonstratat armiqësore të organizohen edhe në Ferizaj. I akuzuari Nezir ka marrë përsipër angazhimin në drejtim të organizimit të demonstratave armiqësore dhe duke i analizua mundësitë i tregon të akuzuarit Halil se në QAMO në Ferizaj, ka disa njerzë nga radhët e punëtorve të arsimit për aktivitet armiqësor, mirëpo mundësi më të mëdha ka në shkollën fillore ku është i punësuar dhe merr mbi vedi obligimin që me përpjekje maksimale të organizon nxënësit për të dalur në demonstrata armiqësore. Me atë rast merren vesh edhe se cilat parulla, me çfarë përmbajtje duhet pregaditur për dalje në demonstrata, të cilat duhet të jenë sa më masovike dhe në të cilat duhen të marrin pjesë pjesëtarët e të gjitha strukturave të qytetarve. Pas premtimit në angazhimin e tij në këtë drejtim, i akuzuari Nezir Haliti, disa ditë pas organizimit dhe mbajtjes së demonstratave në Ferizaj, shkon në fakultet dhe të aku-

zuarit Halil i raporton lidhur me organizimin e demonstratave, pjesëmarrjen e masave, kurse i akuzuari Halil i përgjigjet se edhe më tejë duhet vazhdua punën në këtë mënyrë, që populli të mbahet në këtë gjendje, duke shkrua parulla armiqësore dhe duke shpërndarë afishe e me të cilat propozime i akuzuari Nezir pajtohet plotësisht. Lidhur me këtë bisedë, i akuzuari Halil, në një rastë, në fakultet e njofton edhe të akuzuarin Ukshin Hotin, i cili i përgjigjet "se mirë është dhe kështu duhet vazhdua".

Pas demonstratave, në bisedat e zhvilluara me të akuzuarin Shemsi Reçicen, i njëjti i thotë të akuzuarit Halil, pasi i përkrahë demonstratat armiqësore, se mirë është që po mbahen demonstratat, në të cilat është paraqitë kërkesa për republikën e Kosovës, se duhet vazhdua edhe më tejë dhe në mënyrë më masovike, duke shkruar parulla, afishe, e pastaj së bashku bëjnë krahasimin e demonstratave në Kosovë me demonstratat jashtë vendit. Në këto biseda i akuzuari Shemsi, është deklaruar se për ta fitua statusin e republikës në Kosovë, duhet të ndërmerren aksione konkrete dhe se është i gatëshëm, sikurse edhe i gjithë populli, por meqëse është koha e vjeshtës Shemsiu propozon që aksionet konkrete të ndërmerren në pranverë, kur kushtet klimatike janë më të volitëshme, për daljen e njerëzve në male.

I akuzuari Halil Alidema, të akuzuarit Mentor Kaçit i ka tregua për kontaktin që ka patur me përfaqësuesin e Konzulatit të Shqipërisë në Stamboll, duke i dhënë për detyrë që në teritorrin e Komunes së Gjakovës, të mbledhë shenimet mbi forcat e armatës popullore, forcat e milicësë, dhe ku janë të përqëndruara, e këtë detyrë i akuzuari Mentor e merr mbi vedi, për të cilën gjë më vonë i ka sjellur shenimet me numërat konkrete.

I akuzuari Halil Alidema, të akuzuarit Ali Kryeziut i jep për ta lexua pamfletin e Qendres për edukimin marksist pranë KQ të PKMLSHJ me titull "Teoria dhe praktika e revolucionit", i cili është pajtua me përmbajtjen e materialit dhe qëllimet e parashtruara në te, se duhet shkua deri ke kryengritja e armatosur, duke propozua që për një punë të tillë nevojitet angazhimi i të gjitha strukturave të popullit shqipëtar dhe se popullin duhet mbajtur në një situatë të tillë, duke vazhdua edhe mëtej me shkrimin e parullave dhe ndarjen e pamfleteve.

I akuzuari Halil Alidema, në kontaktin e tij me të akuzuarin Muharrem Fetium, i është drejtua, duke i thënë se a është i gatëshëm për të angazhua persona, të cilët kishin për të veprua në mënyrë armiqësore në vendlindjen e tij, e në këtë rast i akuzuari Muharrem, i është përgjegjë se për një punë të tillë, nuk është i gatëshëm dhe nuk mund ta kryej.

I akuzuari Ekrem Kryeziu, i ka dhënë të akuzuarit Ukshin Hotit materialin propagandistik armiqësor në formë të pamfletit nga revista "Liria nr.3." të organizatës ilegale Marksiste Leniniste të Kosovës me titull "Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe patjetër do të triumfojë". Pasi që e lexon i akuzuari Ukshin, shprehet se si material në tërësi është i mirë dhe të njëjtin e për-krahë, mirëpo shton se stili i shkrimit është mjaftë i ultë. I akuzuari Ekrem Kryeziu bashkë me të akuzuarit Halil Alidemen dhe Ukshin Hotin, në shtator të vitit 1981. artikullin e përmendur e lexojnë dhe komentojnë së bashku, e gjatë bisedes, temë kryesore, ishte situata momentale në Kosovë, me çrast i akuzuari Halil shprehë mendimin se atmosferën e elektrizuar duhet majtë dhe vazhduar me shkruarjen e parullave dhe shpërndarjen e afisheve, ndërsa i akuzuari Ukshin, është deklarua se aktiviteti kryesor du-



het të orjentohej në mobilizimin e masave dhe organizimin e tyre për luftë të armatosur, të cilën duhet zbatuar me principin e geriles, duke qenë i bindur se masat e gjëra janë të gatëshme për një aksion të tillë. I akuzuari Ukshin me rastin e vizitës familjare që i bëri i akuzuari Ekrem, të njejtit i propozon që të emigrojnë në SHBA, duke kërkuar azil politik në Ambasadën e SHBA në Greqi, pasi atje kishin për të kontribuar më tepër për të drejtën e fitimit të pavarsisë më të madhe të Kosovës dhe statusin e republikës, kishin për të kontaktuar me përfaqësuesit e RPS të Shqipërisë, duke aktivizuar lidhjet e tyre dhe njëherit duke krijuar lidhje të reja.

I akuzuari Halil Alidema, e ka angazhuar të akuzuarin Ekrem Kryeziun që të formojë grupin e 10-it në emër të organizatës ilegale të PKMLSHJ, duke i folur se qfarë duhen të jenë ata, gadishmërinë e tyre edhe për luftë të armatosur, për të cilën luftë armët kishin meqenë të siguruar nga SHBA., duke e këshilluar që Mentor Kaçin mos ta fusin në grupin e dhjetëshit, sepse me të ka pasur kontakte dhe i ka dhënë detyra të tjera konkrete. Në një rast takimi, i akuzuari Mentor Kaçi i tregon të akuzuarit Ekrem Kryeziut, se nga i akuzuari Halil, ka marrë detyra konkrete lidhur me vërtetimin e gjendjes të organeve të sigurimit në Kosovë dhe përcjelljen e disponimit të popullit.


Në një bisedë, para se të niset në SHBA, i akuzuari Ali Kryeziu, i ka thënë të akuzuarit Ekrem Kryeziut se do të angazhohet në mbledhjen e ndihmave në të holla nga emigrantët e atjehit, të cilat do të përdoren për të blerë armë.

Në bisedën e zhvilluar me të akuzuarin Mentor Kaçin, të njejtit, i akuzuari Halil Alidema, pasi këthehet



nga pushimi veror në Turqi, i tregon se si në Stamboll ka kontaktua me përfaqësuesit e Konzulatës të RPS Shqipërisë, e pastaj i ka dhënë për detyrë që në Gjakovë të mbledh shenime lidhur me numërin e pjesëtarve të APJ. dhe atyre të milicisë, e pas 2-3 ditësh i ka raportua për numërin e ushtarëve, vendosjen e tyre afër "Erenikut", numërin e automjeteve, duke pranua propozimin dhe detyren që të siguroi listën e studentëve, të cilët nuk kanë fitua të drejtën e regjistrimit në fakultete dhe shkolla të larta në Univerzitetin e Kosovës, në mënyrë që të dërgohet një peticion në shtetet e perëndimit për ti njoftua për gjendjen dhe "padrejtësitrat" në Kosovë.

I akuzuari Hilmi Ratkoceri, pas kontakteve, ndejave dhe marrëveshjeve me të akuzuarin Halil Alidemen, i pranonë idetë e të akuzuarit Halil për angazhim në veprimtari armiqësore në drejtim të realizimit të kërkesës për statusin e republikës të Kosovës dhe të bashkimit të popullit shqipëtar, duke e njoftua të akuzuarin Halil për shkruarjen e parullave me përmbajtje armiqësore në Shkollon e mesme në Ferizaj në vitin 1979., për thyerjen e fotografisë të Shokut TITO, nxënësit që kanë krya këto aksione dhe masat që janë ndërmarrë ndaj tyre, kurse pas demonstratave armiqësore të muajit mars e prill të vitit 1981., në kontaktet me të akuzuarin Halil, i përkrahë demonstratat armiqësore dhe kërkesat e parullat e demonstratave, duke i premtua sigurimin e geshtetnerit për shumimin e materialit propagandistik si dhe angazhimin e tij në kontaktet me persona për formimin e grupit, duke veprua në masovizimin e aktivitetit armiqësor. Merren vesh që i akuzuari Halil të shkoi në Ferizaj për të kontaktuar me personat e angazhuar dhe për ti furnizua me material propagandues me përmbajtje armiqësore dhe këshillua për veprimet që duhet ndërmarrë në mënyrë që të elektrizoi dhe frymëzoi masën në drejtim të kërkeses që Kosova



të fitoi Statusin e republikes.

I akuzuari Halil Alidema, e angazhon të akuzuarin Ali Kryeziun, para se i njejti të shkonte në SHBA që atje të kontaktoi me ambasadorin e RPS të Shqipërisë dhe ta njoftoi për situatën dhe gjendjen në Kosovë dhe këtë angazhim i akuzuari Ali nuk e kundërshton.

Të akuzuarit Ekrem Kryeziu e Ukshin Hoti, së bashku në shtëpinë e dëshmitarit Xhemajl Dana, në Krushen e Madhe, dëgjuan inqizime në shiritin magnetofonik të artikullit nga gazeta "Zëri i Popullit" që është emitua në valet e radios dhe TV të Tiranës, ndërsa i akuzuari Ukshin Hoti në shtëpinë e vet dy herë inqizoi në shirit magnetofonik artikuj tjerë të gazetës "Zëri i popullit" e që janë emitua në valet e radio dhe Tv të Tiranës, me të cilët artikuj përkrahen demonstratat e marsit dhe prillit të vitit 1981. në Kosovë dhe sulmohet sistemi i RSFJ.

I akuzuari Shemsi Reçica, në shtëpinë e Xhevat Reçices, në fshatin Gllavicë, musafirëve të pranishëm, ku ishte edhe dëshmitari Gani Osmani, u ka folë që duhet të vazhdohet kërkesa e realizimit të statusit të Republikës të Kosoves me hatër apo me dhunë, ndërsa në shtëpinë e vet poashtu në fshatin Gllavicë, dy herash inqizoi në shirita magnetofonik artikuj të gazetës "Zëri i popullit", të cilët janë emitua përmes të TV të Tiranës e me të cilët përkrahen demonstratat dhe kërkesat e demonstratave si dhe sulmohet sistemi i RSFJ si dhe i udhëheqësisë së saj.. Po ashtu i akuzuari Shemsi Reçica, gjatë pushimeve verore të vitit 1981. në Varnë të Bullgarisë, ka kontaktua me përfaqësuesit diplomatik të RPS të Shqipërisë me të cilët bisedoi dhe analizoi situatën dhe gjendjen politike në Kosovë pas demonstratave.



Gjendja e mësipërme faktike u vërtetua me këto prova:

Deklaratat e të akuzuarve dhënë në hetuesi, deklaratat e dëshmitarve Zyrafete Mustafa e Gani Osmani dhënë në hetuesi, deklarata e dëshmitarit Xhemajl Dana dhënë në hetuesi e në shqyrtimin kryesor. Me provat materiale, vështrimin fotodokumentacionit të hetimit 02-nr.2435. të datës 15.11.1981. të Shërbimit të sigurimit publik SPB -- Prishtinë, vështrimin në materialin me titull "Teoria dhe praktika e revolucionit të qendres për edukimin Marksist pranë KQ të PKMLSHJ të vitit 1980", vështrimin në materialin "Teoria praktika e revolucionit për çlirimin kombëtar të shqipëtarve në Jugosllavi" me nëntitull "nuk ka barazi nacionale pa barazi dhe pavarësi ekonomike-politike dhe territoriale" të Qendres për edukimin Marksist pranë KQ të PKMLSH, vështrimin në materialin me titull "Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe patjetër do të triumfojë", artikull i marrë nga "Liria" organ i Marksistë-Leninistëve të Kosoves, me vështrimin në raportin e Spitalit të përgjithëshëm në Shkup të datës 15.12.1981., për të akuzuarin Halil Alidemen, bëhet vështrimi në letren e shkruar në një pjesë të mbështjellëses së çokollades të akuzuarit Ekrem Kryeziut e datës 04.01.1982. dhe shenimi zyrtar i datës 29.04.1982. për të akuzuarin Ukshin.

Pasi i ka vlerësua të gjitha provat e nxjera në shqyrtimin kryesor, Gjykata erdhi në përfundim se gjendjafaktike e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, është argumentua plotësisht.

Duke analizua çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat etjera, si dhe faktet e vërtetuara në këtë mënyrë, Gjykata ka gjetur se në veprimet e të të akuzuarvet Halil Alidema, Ekrem Kryeziu, Ukshin Hoti, Mentor Kaci, Hilmi Ratkoceri, Ali Kryeziu, Nezir Haliti e Shemsi Reçica ekzistojnë të gjithë elementet qënësore-objektive



e subjektive të veprave penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114.i LP RSFJ., ndërsa në veprimet e të akuzuarit Muharrem Fetiut, elementet qënjësore të vepres penale Mosëkallëzimi i përgaditjes së vepres penale nga neni 172.al.1. të LP SAPK. dhe meqë se mungojnë rrethënat ligjore, të cilat do të përjashtonin, apo do të zvoglonin përgjegjësinë e tyre penale, të akuzuarit i deklarën fajtor për veprat e kryera penale si në dispozitiv të këtijaktgjykimi.

Gjykata me kujdesë të veçantë vlerësoi mbrojtjet e të akuzuarvet dhe të mbrojtësve të tyre, por të njejtat nuk i aprovon, sepse në shqyrtimin kryesor të akuzuarit pabazë mohojnë deklaratat e tyre dhënë në hetuesi, duke i justifikua se ato deklarata i kanë dhënë nën presionin e personave të autorizuar të SHSSH. dhe kështu kanë qenë të detyruar të nënshkruajnë deklaratat, të cilat përndryshe i kanë përpiluar vet personat e autorizuar.

Së pari përpjekja e të akuzuarit Halil Alidemes se është torturuar fizikisht e psikikisht dhe se me rastin e torturimit i janë thyer disa brinjë, u demantua plotësisht në bazë të raportit të Spitalit të përgjithshëm të qytetit në Shkup nga i cili u konstatua se plagosjet ~~traumatike~~ traumatike në gjoksin e të akuzuarit Halil Alidemes, sipas inqizimevet dhe fotografive rentgenologjike, janë të kahershme dhe se nuk janë gjetur shenja të plagosjevet të reja.

Nga letra, e cila u lexua në shqyrtimin kryesor, e të cilën i akuzuari Ekrem Kryeziu iashkruajti të vllait Aliut në Burg, rezulton fakti se nuk janë përdorë forcat fizike e as dhuna.




Nga deklaratat e të akuzuarve të dhëna në hetuesi dhe në bazë të pjesëve të tjera të deklaratave të akuzuarvet Ekrem Kryeziut, Mentor Kaçit, Halil Alidemes, Ukshin Hotit e Shemsi Reçices, lidhur me shkëmbimin e materialeve propagandistike, siq janë pamfletet e organizatave të përmendura armiqësore, pastaj të inqizimeve të propagandes nga RPSSH., në mënyrë të kjartë konstatohet se nuk kemi të bëjmë vetëm me bisedat e përditëshme në mesin e shoqërisë të ngushtë dhe të rrethit familjar në analizimin e ngjarjeve kontrarevolucionare në Kosovë të vitit 1981., ashtu sikundër mbrohen të akuzuarit, por përkundrazi me një veprimtari armiqësore dhe të planifikuar për përkrahjen dhe vazhdimin e aksioneve të kontrarevolucionit me aksione konkrete.

Nga detalizimet e deklaratavet të të gjithë të akuzuarvet të dhëna në procedurën e hetuesisë, rezulton një përputhëshmëri e gadi secilit të akuzuar lidhur me veprimtarinë e vet në lidhmëri me veprimtarinë e të akuzuarve të tjerë, kështu që në këtë mënyrë demantohet mundësia e çdo montimi aq të përsosur të prezentuara me spjegimet dhe detalizimet e të akuzuarvet lidhur me ngjarjet dhe përshkrimin konkret të veprimtarive të tyre.

Gjithashtu paraqitet e pabazë edhe përpjekja e të akuzuarvet kur nëseancën gjyqësore pohojnë se vetëm kanë nënshkrua deklaratat në hetuesi ashtu siq janë përpi-lua nga personat e autorizuar, e kjo rezulton nga vetëprocesverbalet ku kjartë shifet setë akuzuarit në dorëshkrim kanë bërë përmirësimin e fjalëve të radhituranë fjali.

E pavërteta në mbrojtjet e të akuzuarvet Halil Alidemes dhe Shemsi Reçices që gjatë hetimevet janë maltretuar për së tepërmi dhe se gjyqtari hetues pa mbështetje në asnjë argument e ka fillua procedurën, rjedhë nga absurdi në këto deklarata siq janë se të akuzuarin Halil



Alidemen e kanë maltretuar nën temperaturë prej mase 100 shkallësh, si dhenga ajo se në shkresat e lëndës ekziston deklarata etë akuzuarit Shemsi Reçices dhënë para se të vijë ke gjyqtari hetues.

Nuk është me bazë as mbrojtja e të akuzuarve Ukshin Hoti dhe Shemsi Reçices, se inqizimet e propagandes nga RPSH i kanë bërë për nevojat shkencore, këtë nga shkaku se çdo personi qoftë edhe ai i cili nuk merret me shkencë i është e njoftur se për punime shkencore, nuk vihet në këtë mënyrë. Sikur të ishte ashtu, si mbrohen këta të akuzuar, parashtrohet pyetja se pse vallë të akuzuarit nuk e shfrytëzuan autoritetin e tyre që këto kërkesa kontrarevolucionare e armiqësore ti demaskojnë dhe njëherit ti spjegojnë qëllimet e tyre reacionare. Për kundër këtij fakti të akuzuarit këto kërkesa armiqësore i aprovuan dhe vepruan në drejtim të mbajtjes së gjendjes së ndërlikuar në Krahinë në përsëritjen e kërkesave dhe parullave armiqësore, të paraqitura në demonstratat e vitit 1981.

Të akuzuarit Halil Alidema, Ali Kryeziu dhe Shemsi Reçica, bisedojnë për shkuarjen e një personi me autoritet jashtë vendit, i cili nga jashtë kishte me spjegua nevojën e realizimit të parullës "Kosova Republikë" dhe se një paraqitje e tillë do të kishte "efekt". Edhe të akuzuarit Ekrem Kryeziu e Ukshin Hoti, biseduan për shkuarjen në SHBA, nëpërmes të Greqisë, prejnga do të bënin agitim për Republikën e Kosovës. Një shkuarje legale në SHBA., është shkuarje krejtë tjetër prej asaj me azil politik prej një shteti në shtetin tjetër, nga se forcat reacionare shkuarjes së tillë, i japin publicitet, pra ndaj duhet bërë dallimin e shkuarjes në një vend tjetër dhe qëndrimit atje nga kërkesa e azilit politik, nga se në rastin e dytë "publiciteti" është i madh, por nënkupetohet nga ana e forcave ekstreme emigrante.



Bisedat e të akuzuarve Halil Alidemes me Konzulin e RPSSH. në Stamboll dhe Shensi Recices me përfaqësuesit diplomatik të RPSSH. në Varnë të Bullgarisë, e më vonë njoftimi për këtë bisedë të akuzuarit Halil Alidemes, nuk janë të rastit dhe as që mund të merren si biseda spontane, është pyetje e veçantë se si u takuan me përfaqësuesit e konzulatave të RPSSH. në Turqi e Bullgari mu këta dy të akuzuar dhe në kohën pas demonstratave armiqësore të muajit mars dhe prill të vitit 1981.

Të akuzuarit Ukshin Hoti dhe Ekrem Kryeziu, në shqyrtimin kryesor e shofin të arsyeshëm dhe lejojnë mundësinë e diskutimit rreth kërkesës për statusin e republikë të Kosovës, por siq e spjegojnë ata në kuadër të LKJ. dhe në suaza të RSFJ. Kjo është një taktikë e re, por me dëmthënje të vjetër e reaktionare, sikurse janë parullat armiqësore e kontrarevolucionare nga demonstratat e vitit 1981. Kur themi këtë, kemi parasysh faktin se pas demonstratave armiqësore të marsit dhe prillit të vitit 1981., këta të akuzuar përpjekën të na spjegojnë se është e mundëshme që Kosova të bëhet republikë, por në kuadër të LKJ.. Ndërkaq, dihet fare mirë se të gjitha forcat progresive, organizatat shoqërore, politike e të tjera, i kanë gjykua të gjitha parullat armiqësore, poashtu edhe parullen "Kosova Republikë", si parullë armiqësore e kontrarevolucionare të drejtuar në rrëzimin e pushtetit dhe klasës punëtore e të punonjësve, prishjen e barazisë të kombëve dhe kombësive dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të RSFJ.. Pra, këta të akuzuar në mënyrë perfide e aktualizojnë këtë parullë armiqësore, jo vetëm pas qëndrimeve unanime të të gjitha forcave progresive në vend, por edhe gjatë shqyrtimit kryesor. Bisedat që i pati i akuzuari Ukshin Hoti me mbrojtësin e tij në lokalet e Burgut, është poashtu dëshmi se ai në tërë qenjen e vet e përkrahë parullen armiqësore "Kosova Republikë"

por siq thot ai në kuadër të LKJ.. Një deklaratë e tillë është strategji e maskuar me të cilën shërbehet i akuzuari.

I akuzuari Ekrem Kryeziu, në deklaratën e tij gjatë shqyrtimit kryesor thekëson se "demonstratat, popullin shqipëtar në Kosovë e kthejnë prapa për disa dekada" por është e vërtetë se edhe ky i akuzuar edhe të akuzuarit të tjerë me veprimet e tyre, veçanërisht pas demonstratave armiqësore, e patën të njejtin qëllim.

Të akuzuarit jo vetëm që i përkrahën demonstratat armiqësore, kontrarevolucionare e irredentiste të muajit mars e prill të vitit 1981., por siq u vërtetua gjatë shqyrtimit kryesor në shumë takime e biseda vazhduan aktivitetin armiqësor në ndërmarrjen e aksioneve konkrete. Ata kishin për qëllim që të sigurojnë kontiunitet të veprimit armiqësor të organizimit të demonstratave të sërishtme, të shpërndarjes së parullave, afisheve e pamfleteve me përmbajtje armiqësore dhe njëherit të shkaktojnë edhe më tutje shqetësim në opinionin publik duke e mbajtur gjendjen e ndërlikuar në krahinë. Prandaj, këto aksione të tyre, në realitet paraqesin aksione armiqësore ndaj revolucionit tonë, sistemit tonë socialist vetëqeverisës të interesave të klasës punëtore dhe të vetë kombësisë shqipëtare në vend. Mirëpo, me vendosmëri është demaskua esenca reaksionare e parulles nacionaliste dhe irredentiste "Kosova Republikë", e cila paraqet sulmin e fryteve të revolucionit, rregullimit kushtetues të RSFJ. të interesave dhe të unitetit të kombeve e të kombësive të Kosoves, të RS të Sërbisë dhe të RSFJ. Ndërkaq, të akuzuarit, të shkolluar nga kjo bashkësi socialiste vetëqeverisëse, keqpërdoruan të gjitha privilegjet dhe të mirat me veprimet e tyre armiqësore e kontrarevolucionare.



Mbrojtja e të akuzuarit Hilmi Ratkocerit dhe mohimi i aktakuzes nga ana e tij, ngelen të pambështetura në ndonjë argument. Te gjyqtari hetues deklarohet se "të gjitha raportet dhe kontaktet e tij me të akuzuarin Halil Alidemen, në detaje i ka sqarua në deklaratën SHSSH. dhe e konsideron të panevojshme përsëritjen". Ndërkaq, me vështrimin e bërë në deklaratat pranë SHSSH. konstatohet se i akuzuari ka bërë përmirësimin e tekstit të shtypur me makinë, që dotë thotë se ka qenë plotësisht i vetëdijshëm kur të njejtat i nënshkruan dhe se ndaj tij nuk është përdorë dhuna apo tortura. Gjykata vërtetoi se veprimtaria armiqësore e të akuzuarit Hilmi përpos përshkrimit të hollësishëm nga vet ai, u argumentua edhe me përshkrimin identik të paraqitur nga i akuzuari Halil Alidema.

As mbrojtja e të akuzuarit Nezir Halitit, nuk arsyeton aprovimin e saj, kjo në praninë e deklaratave të akuzuarve Halil Alidemes dhe Hilmi Ratkocerit, të dhëna në procedurën paraprake, të cilat edhe pse janë dhënë veçmas, në mënyrë identike dhe në detaje paraqesin veprimtarinë armiqësore të këtij akuzuari, i cili pabazë e mohon akuzën.

I akuzuari Muharrem Fetiu, në shqyrtimin kryesor mohon akuzën. Arsyetohet se i akuzuari Halil Alidema, nuk i ka lënë përshtypje që ka ndërmarre veprimet inkriminuese. Ndërkaq, në hetuesi deklarohet se nuk pajtohet me mendimet e të akuzuarit Halil, por të njejtin nuk e paraqet, sepse siq thot "as që i kashkuar mendja se fjala është për një veprimtari serioze armiqësore". Vërtetë, një mbrojtje e tillë është pakurfarë bazash, sepse fare nuk ka qenë vështirë të fitohet bindja për veprimtarinë armiqësore të akuzuarit Halil Alidemes, gjatë bisedave dhe kontakteve të përditëshme që i patën këta dy të akuzuar, në të cilat i akuzuari Halil kjartë është eksponua dhe deklarua nga pozitat e kontrarevolucionit dhe armiqësisë ndaj vendit.



Me vlerësimin e mbrojtjes, sa i përket inqizimeve magnetofonike të artikuljve mepërmbajtje armiqësore dhe dëgjimi i tyre, u vërtetua se ato nuk u bënë për qëllime shkencore, apo për aktivitet, i cili kishte me i demantua, por për "nevojat e rrethit të ngushtë" të akuzuarvet në vazhdimin e veprimtarisë së tyre armiqësore.

Në të njejtën mënyrë dhe qëllim u përdor edhe materiale propagandistik - armiqësor, të cilin të akuzuarit e lexuan, komentuan dhe "e ruajtën për nevojat e tyre". Pamfletet që u nxorën si provë në shqyrtimin kryesor paraqesin materiale ilegale armiqësore me të cilat në mënyrën më tëvrazhdë sulmohet sistemi i ynë vetëqeverisës socialist, bashkëjetesa, barazia kombëtare e sociale, rregullimi kushtetutar i RSFJ.. Kërkohet ekzistimi i një partie jashtë LKJ., aq më tepër është përpilua "programi", "statuti" dhe janë dhënë "instrukcionet" për zhvillimin e popullit shqipëtar në "territorin e vet etnik", sepse siq shkruan mëtutje në këto materiale armiqësore "vllëzërit të cilët nuk sillen vllazërisht ndaj njëri tjetërit, bënë armiqë - Tito". Demonstratat e Kosoves paraqiten si "vepër e popullit", përkrahet parullaarmiqësore "Republika e Kosoves", kurse "Zëri i popullit", paraqitet si "zëri i së vërtetës". Në bazë të vetëm këtyre sekvencave të nxjerra nga materialet ilegale, nuk është vështirë të konstatohet karakteri i veprimtarisë armiqësore i të akuzuarvet.

Gjykata konstaton se mbrojtja pabazë potencon shkeljen e dispozitave të Ligjit mbi procedurën penale, nga se në shkresat e lëndës ekziston aktvendimi i formes së prerë me të cilin mbrojtësit i mohohet e drejta e shikimit të shkresave të lëndës.

Gjykata vlerësoi deklaratën e dëshmitares Zyrafete Mustafa, e cila në shqyrtimin kryesor u shpreh në

